



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Ministri

MIRATOHET

MINISTRI I
PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

SOKOL OLLDASHI



UDHËZIM

Nr...*18*...datë *16.10*...2008

Për Çertifikimin e një Ofruesi Shërbimesh të Navigimit Ajror

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, në përputhje me Ligjin 9658, datë 18.12.2006, për ratifikimin e "Marrëveshjes Shumëpalëshe midis Komunitetit Evropian dhe Shteteve të tij Anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjes dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Mbi Krijimin e një Zone të Përbashkët Evropiane të Aviacionit",

UDHËZOJ :

KAPITULLI 1

Të përgjithshme

1. Qëllimi

1.1 Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i objektivave për të garantuar implementimin dhe vënien në zbatim të KRRSE1/ESARR1 dhe kryerjen e procesit të Çertifikimit të Ofruesve të Shërbimeve të Navigimit Ajror.

2. Organet zbatuese

2.1 Ngarkohet DPAC, si organi i ngarkuar edhe me funksionet e Autoritetit Kombëtar Mbikqyres (AKM), të garantojë zbatimin e këtij Udhëzimi.

2.2 DPAC do të mbikqyre dhe do të garantojë zbatimin me përpikmeri të rregullave të vendosura në këtë Udhëzim, nga Ofruesit e Shërbimeve të Navigimit Ajror.

2.3 Kërkesat e përgjithshme të këtij Udhëzimi do të zbatohen nga departamentet e përcaktuara të Aviacionit Civil, ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror dhe nga i gjithë personeli i shërbimit të menaxhimit të trafikut ajror (MTA), përgjegjës për detyrat, të cilat brenda janë përcaktuar si të lidhura ngushtë me sigurinë.

2.4 Kërkesat do të zbatohen tek:
departamentet e përcaktuara të Aviacionit Civil, organizmat operative dhe individët e personelit, të cilët nepermjet pajisjeve të MTA të aprovuara për përdorim operacional, garantojnë shërbime.

3. Kërkesat e Sigurisë

3.1 Kërkesa të Përgjithshme

Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil duhet të garantojë, përmes aplikimit të auditimeve dhe proceseve rregullatore përkatëse, që organizmat dhe personeli përgjegjës për detyrat në lidhje me shërbimin e trafikut ajror apo që mbulon fushën e shërbimeve të trafikut ajror, të cilat janë konsideruar të lidhura me sigurinë e trafikut ajror, ka zbatuar detyrat sic janë të përcaktuara në këtë udhëzim.

3.2.1 Kërkesa të zbatuara nga DPAC

DPAC, është përgjegjëse që:

- a) të garantojë mbikqyrjen e përshtatshme dhe të mjaftueshme të rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim.
- b) të kryejë, pas hulumtimit përkatës mbi një terren të pranueshëm, veprimin rregullues përkatës në përputhje me specifikimet e këtij udhëzimi dhe me dispozitat e OSHNA.

3.2.2 Kërkesa të zbatueshme nga OSHNA.

Një OSHNA do të:

- a) garantojë implementimin e detyrave që i linden asaj në bazë të përcaktimeve të këtij udhëzimi;
- b) garantojë që, në lidhje me procedurat e përcaktuara nga ky udhëzim, të dhënat që ekzistojnë, janë dokumentuar nga OSHNA, dhe vihen në dispozicion, me kërkesë të D.P.A.C.-së;
- c) garantojë që, nga një pikëpamje sigurie, metodat përkatëse të zgjedhura janë ato që duhen, për të garantuar plotësimin e dispozitave të zbatueshme të këtij Udhëzimi;

4. PËRJASHTIME

Në rastin e ekzistencës së rrethanave që bëjnë të pamundur zbatimin e kërkesave të (KRRSE/ESARR) 1, DPAC do të bëjë vlerësimin e tyre dhe me pas do të publikojë zyrtarisht, një dokument përjashtimi, i cili do të garantojë një nivel ekuivalent sigurie.

5. Termat e përdorur

5.1 Termat dhe shkurtime të përdorura në këtë Udhëzim sqarohen në shtojcën A, bashkëlidhur këtij Udhëzimi dhe përbejnë pjesë integrale të tij.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KAPITULLI 2

Çertifikimi i një Ofruesi Shërbimesh të Navigimit Ajror

1. Një OSHNA do të ofrojë shërbime të navigimit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë vetëm nëse mban një certifikatë të vlefshme për të ofruar shërbime të tilla.
2. DPAC ne ushtrim të funksioneve të AKM do të certifikojë OSHNA-të/Njësitet që do të ofrojnë shërbim në Republikën e Shqipërisë.
3. Çertifikimi nga ana e DPAC-së për të ofruar shërbime do të kryhet vetëm nëse OSHNA-te/Njësitet operojnë në përputhje me Kërkesat e Përbashkëta për ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror të parashtruara në aktet normative që lindin si detyrim i "Marrëveshjes Shumepalëshe për Krijimin e një ZPEA".
4. Para se të japë certifikatën për të ofruar shërbime DPAC-ja, do të kryejë mbikqyrjen e atij Ofruesi dhe/ose Njësie në përputhje me Kërkesat e Përbashkëta dhe ESARR 1. Mbikqyrja do të kryhet duke audituar OSHNA-të/Njësitet dhe duke verifikuar përputhshmërinë me këto kërkesa.
5. Një Çertifikatë për të ofruar SHNA do të jetë e kufizuar në kohë dhe mund të përmbajë kushte të vecanta të përcaktuara nga DPAC-ja.
6. Çdo Shërbim Navigimi Ajror i ofruar do të kryhet në përputhje me kushtet e çertifikimit. Pas çertifikimit DPAC mbikqyr në mënyrë të vazhdueshme kryerjen e aktivitetit të OSHNA-ve/Njësive në përputhje me Kërkesat e Përbashkëta dhe me kushtet e përcaktuara në certifikatë. Në rastet kur konstatohen mospërputhje me kërkesat dhe kushtet e mësipërme, DPAC do të marrë vendim brenda një afati kohor prej jo më shumë se 30 ditësh, me anë të të cilit do të kërkohet OSHNA-së/Njësitet kryerja e veprimeve korrektuese.
7. Një OSHNA/Njësi që kërkon të marrë një certifikatë nga DPAC për të ofruar Shërbime Navigimi Ajror do të aplikojë tek DPAC duke përdorur "Formularin 1" bashkelidhur me këtë Udhezimi. Aplikimi do të kryhet minimalisht 120 ditë për OSHNA dhe 60 ditë për Njësitet përpara datës së planifikuar për marrjen e certifikates.

8. Një OSHNA/Njësi që nuk do të ofrojë shërbime ndërkufitare do të aplikojë tek DPAC për një Certifikatë të Kufizuar duke përdorur "Formularin 1".

Certifikata e Kufizuar është e vlefshme vetëm brenda hapësirës ajrore nën përgjegjësinë e REPUBLIKES SË SHQIPËRISË.

Për të bërë një aplikim për një Certifikatë të Kufizuar, një ofrues i shërbimeve të trafikut ajror duhet të ofrojë shërbime ose të planifikojë për t'i ofruar ato, vetëm për kategoritë e mëposhtme:

- a) aviacionin e përgjithshëm;
- b) punët ajrore;
- c) transportin ajror komercial të kufizuar për avionat me masë maksimale të ngritjes me më pak se 10 ton ose më pak se 20 vënde pasagjerësh;
- d) transportin ajror komercial me më pak se 10,000 lëvizje në vit, pavarësisht nga masa maksimale e ngritjes dhe numri i vëndeve të pasagjerëve, 'lëvizjet' të llogaritura si shuma e uljeve dhe ngritjeve dhe e llogarituar si një mesatare mbi tre vitet pararendëse.

Për të bërë një aplikim për një Certifikatë të Kufizuar, një OSHNA i ndryshem nga ofruesit e Shërbimit të trafikut ajror, duhet të ketë një sasi të ardhurash bruto prej 1 000 000 EURO ose më pak nga shërbimet që ai ofron ose planifikon të ofrojë.

Për të bërë një aplikim për një Certifikatë të Kufizuar, një aplikant që ofron shërbime të Informacionit të fluturimit në aerodrome duhet të operoje rregullisht jo më shumë se një pozicion pune në çdo aerodrom.

9. Pavarësisht nga paragrafi 3 i këtij kapitulli, Certifikata e Kufizuar do të përfshijë disa devijime të veçanta në përputhje me aktet normative që lindin si detyrim i "Marrëveshjes Shumepalëshe për Krijimin e një ZPEA" mbi Kërkesat e Përbashkëta.
10. OSHNA-të/Njësitë që aplikojnë për çertifikim, gjatë aplikimit do të paraqesin dokumentacionin e specifikuar në Paragrafin 11 të këtij kapitulli dhe çdo kërkesë tjetër të kërkuar nga DPAC-ja dhe do të ndihmojnë e bashkëpunojnë siç kërkohet me auditimet dhe inspektimet.
11. Një OSHNA do t'i paraqesë DPAC-së një prezantim organizativ që do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
- Një deklaratë të firmosur nga Shefi Ekzekutiv i Organizatës ose ekuivalenti i tij që konfirmon se dokumentacioni i organizatës dhe çdo dokumentacion referues bashkëngjitur përshkruan përputhshmërinë aktuale dhe atë në vazhdim të organizatës me të gjitha Kërkesat e Përbashkëta dhe që pranon t'i japë DPAC-së çdo informacion për vlerësimin e përmbajtjes së prezantimit;

- Politikën e sigurisë (të organizatës në përputhje të Kërkesave të Përbashkëta në zbatim të marrëveshjes të ZPEA.
- Pozicionet e punës dhe emrat e drejtuesve kryesore të organizatës;
- Përgjegjësitë dhe përgjegjshmëritë e drejtuesve kryesore në lidhje me vënien në zbatim të Kërkesave të Përbashkëta në zbatim të marrëveshjes të ZPEA duke përfshirë:
 - i. Një përshkrim të plotë të funksioneve të menaxhimit të sigurisë të përcaktuara në organizatë me përgjegjësi për përpunimin dhe menaxhimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë;
 - ii. Përgjegjshmëritë dhe përgjegjësitë si edhe masat përkatëse për të garantuar që drejtuesi kryesor dhe organizata janë aktivisht të përfshirë në menaxhimin e sigurisë;
- Një skemë organizative që tregon qartë përgjegjësitë e menaxhimit në fushat që mbulohen nga Kërkesat e Përbashkëta;
- Një përshkrim të përgjithshëm të burimeve të fuqisë punëtore;
- Një përshkrim të përgjithshëm të pajisjeve të organizatës;
- Fushën e shërbimeve të ofruara nën këtë certifikatë;
- Procedurën për mirmbajtjen e prezantimit tek DPAC-ja si dhe për njoftimin e çdo ndryshimi;
- Një përshkrim të plotë se si organizata përmbush dhe do të vazhdojë të përmbushi Kërkesat e Përbashkëta të cilat mund të përfshijnë referenca specifike ose dispozita të disa, ose të të gjitha dokumentave të mëposhtme:
 - a) Manuali i Menaxhimit të Sigurisë
 - a) Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë (SMS) (duke përfshirë procedurat specifike për çdo njësi);
 - b) Studimi i Situatës së Sigurisë për çdo njësi (nëse është e mundur);
 - c) Manualët e Operimeve të Shërbimit të Trafikut Ajror për çdo njësi;
 - d) Proçeset e trainimit dhe mbrojtjes së kompetencës për kontrollorët e trafikut ajror të kërkuara nga DPAC-ja, ;
 - e) Procedurat inxhinierike për çdo njësi;
 - f) Proceset për trainimin, kualifikimin dhe mbrojtjen e kompetencës për personelin inxhiniero-teknik të këkuara nga DPAC-ja Për Licencimin e personelit inxhiniero-teknik të OSHNA/Njesisë;
 - g) Dokumentacioni garantues i sigurisë që përfshin:
 - i. Informacione për ndryshimet që ndikojnë sigurinë tek çdo njësi;
 - ii. dokumentacionin lidhur me ndryshimet e procedurave të Shërbimit të Trafikut Ajror (instruksionet suplementare ose të përkohëshme, etj.);
 - iii. Vlerësimet e Sigurisë dhe Analizat e Rrezikshmërisë që shoqërohen me ndryshime në operim;

- iv. raportet e investigimit të brendshëm të sigurisë që shoqërohen me raportimet e ngjarjeve, ose të kryera si rezultat i ngjarjeve të lidhura me sigurinë të raportuara nëpërmjet një procesi të brendshëm raportimi;
 - v. protokollet dhe/ose proces-verbalet e takimeve të Komitetit të Sigurisë
 - vi. raportet ose shqyrtimet e inspektimeve të brendshme të sigurisë së bashku me protokollet e evidencës të veprimeve të ndërmarra për të zbatuar rekomandimet përkatëse;
 - vii. raportet e auditimeve të brendshme të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë për përputhshmëri dhe efikasitet.
- h) Sistemi i Garantimit të Cilësisë;
 - j) Manuali i menaxhimit të mbrojtjes fizike
 - k) Plan Biznesi Pesëvjeçar dhe Plani Vjetor;
 - l) Raporti Vjetor.

Lista e mësipërme nuk është përfundimtare dhe e fundme. OSHNA-të/Njësitë do të paraqesin dokumentat e mësipërme në përputhje me llojin e aplikimit për çertifikim.

Formulari 1–Formular Aplikimi Model për Çertifikimin e një OSHNA

APLIKIM PËR ÇËRTIFIKIMIN E NJË OFRUESI TË SHËRBIMIT TË NAVIGIMIT AJROR

Formulari Model 1
- Faqe 1/3

DPAC
Rruga Muhamed Gjolllesha Pranë Parkut të
Delegacioneve P.O Box 205.
Tiranë

Aplikim për Çertifikim Fillestar
Aplikim për Ndryshim
(shëno siç duhet)

1. Emri i Aplikantit të Regjistruar

2. Emri Tregëtar (nëse ndryshon)

3. Adresa

4. Detajet e Kontaktit

Emri

Tel

Fax

e-mail

5. Fusha e shërbimit për të cilin është Kërkuar Çertifikimi

SHTA KNS SHIA MET

(për një përshkrim të detajuar, lutemi t'i referoheni Faqes 3 të këtij formulari aplikimi)

6. Emri i Shefit Ekzekutiv

(ose ekuivalenti i tij brenda organi zatës)

7. Nënshkrimi i Shefit Ekzekutiv

(ose ekuivalenti i tij brenda organi zatës)

8. Vendi dhe DATA

(vendi)

(Data)

E NJË OFRUESI TË SHËRBIMIT TË NAVIGIMIT AJROR

9. **Ekspozeja e Organizatës** (shëno siç duhet)

Aplikim për Çertifikim Fillestar

Tre kopje të ekspozesë së organizatës janë paraqitur së bashku me këtë formular aplikimi

Aplikim për Ndryshime

Tre kopje të faqeve të modifikuara në ekspozenë e mëparëshme të organizatës janë paraqitur së bashku me këtë formular aplikimi.

10. **Pyetësorët** (shëno nëse duhet)

Pyetësorët e përcaktuar tek procedurat e çertifikimit nga AKM janë paraqitur bashkë me këtë formular aplikimi.

11. **Përrjashtime (nëse aplikohen)**

Të plotësohet vetëm nëse organizata aplikon për përrjashtime specifike dhe që përrjashtime të tilla kanë qenë përcaktuar siç duhet nga AKM.

(shëno siç duhet)

aplikanti është i vetëdijshëm që çertifikata nuk do të lejohet për shërbime ndër kufitare dhe që ata nuk do të përfitojë nga e drejta e njohjes reciproke brenda zonës së QVE..

aplikanti që ka si qëllim të ofrojë shërbime SHTA vetëm në lidhje me një ose më shumë nga kategoritë e mëposhtëme:

aviacion i përgjithshëm

punë ajrore

transport ajror komercial i kufizuar për avionët me më pak se 10 ton të peshës maksimale në ngritje ose me më pak se 20 sedilje

transport ajror komercial me më pak se 10.000 lëvizje në vit (llogaritur si shumë e ulje- ngritjeve), pavarësisht nga pesha maksimale në ngritje dhe numri i sediljeve të përdorura të avionit, numrit të lëvizjeve të llogaritura si mesatare e tre viteve paraardhëse

aplikanti është një ofrues i shërbimit të navigimit ajror ndryshe nga një ofrues i shërbimeve të trafikut ajror dhe ka një xhiro bruto vjetore prej 1.000.000 EURO ose më pak në lidhje me shërbimet që kryen ose parashikon të kryejë

aplikanti ofron ose parashikon të ofrojë shërbime AFIS, duke operuar rregullisht në jo më tepër se një pozicion pune tek çdo aerodrom ku ky shërbim është ofruar.

aplikanti ka të dokumentuar evidence përkatëse për të gjitha sa më sipër në ekspozenë e organizatës së tij.

Shënime:

- 1) E aplikueshme vetëm kudo ku është kërkuar nga DPAC në rastin e çertifikimit fillestar.
- 2) Pyetësorët mund të dërgohen në një datë të më vonëshme në varësi të procedurave të përcaktuara nga DPAC.

E NJË OFRUESI TË SHËRBIMIT TË NAVIGIMIT AJROR

12. Përshkrim i Detajuar i Fushës së Veprimitarisë për të cilën është Kërkuar Çertifikimi/Ndryshimi

- a) Përdor aq faqe sa është e domosdoshme për të plotësuar tabelën
- b) Përdor tipet e shërbimeve, pjesët dhe nën-pjesët e tyre siç paraqiten në tabelën e dhënë nga AKM për të përshkruar fushën e veprimitarisë së shërbimeve për të cilën mund të kërkohet/jepet çertifikata.
- c) Plotëso vetëm kutitë e përshtatshme për aplikimin.
- d) Kolona '*Kushtet e Propozuara nga Aplikanti*' duhet të përfshijë të gjitha ato kushte dhe kufizime të identifikuara nga organizata në lidhje me shërbimet për të cilat është kërkuar çertifikimi. Kushtet e propozuara duhet të jenë formuluar qartë dhe që gjenden tek kategoritë e kushteve të mundshme bashkangjitur çertifikatës.
- e) Ku shihet e nevojshme, kushtet mund të përshkruhen me anë të referimeve tek dokumentet bashkangjitur këtij formulari aplikimi ose tek dokumenta të tjera të përshtatshme

Shërbime	Tipi i shërbimit të ofruar	Pjesë e shërbimit të ofruar	Nën-pjesë e shërbimit të ofruar	Kushtet e Propozuara nga Aplikanti (nëse ka ndonjë)
----------	----------------------------	-----------------------------	---------------------------------	---

SHTOJCA A

1. TERMA dhe PËRKUFIZIME

Ne funksion te ketij Udhhezimi termat e meposhtem nenkuptojne:

Autoriteti Kombëtar Mbikqyrës (AKM).

Është ajo pjesë e DPAC-së e autorizuar nga ky Udhëzim i Ministrit të PPTT si organi kompetent i autorizuar për kryerjen e funksionit të mbikqyrjes së Sigurisë në nivel kombëtar, dhe të Shërbimeve të Trafikut Ajror.

DPAC – Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil

Autoriteti rregullator kompetent në varësi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe është përgjegjës për rregullat dhe rregulloret e sigurisë së aviacionit.

ANTA sh.a.

Një agjensi që është nën vartësinë e Ministrisë së Ekonomisë dhe, Ministrisë së Punëve Publike transportit dhe Telekomunikacionit, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të Menaxhimit të Trafikut Ajror.

Shërbimet e Navigimit Ajror (SHNA)

Shërbimet e trafikut ajror; komunikimi; shërbimet e navigimit dhe vëzhgimit, shërbimi meteorologjik i navigimit ajror; dhe shërbimin e informacionit aeronautik.

Ofruesit e SHNA

Person ose organizatë, ose përfaqësues i përcaktuar nga një organizatë, i cili është zbatues i rregulloreve të grupit i mbikqyrës të SHNA.

Manaxhimi i Trafikut Ajror (MTA))

Manaxhimi i Trafikut Ajror. Bashkësia e veprimtarisë në tokë (të përbërë nga ATS, ASM, ATFM) dhe ato funksione të avionit në ajër të nevojshme për të garantuar zhvendosjen e saktë të mjeteve fluturuese gjatë fazave përkatëse të operimit.

Shërbimi i Menaxhimit të Trafikut Ajror

Një shërbim në funksion të Menaxhimit të Trafikut Ajror (MTA).

Ofruesi i shërbimeve MTA

Një organizatë përgjegjëse dhe e autorizuar për të siguruar dhe kryer shërbime të Menaxhimit të Trafikut Ajror (MTA).

Shërbimi i Trafikut Ajror (SHTA)	Një term i përgjithshëm që përmbledh shërbimet e ndryshme të informacionit mbi fluturimin, shërbimin e sinjalizimit, shërbimi konsultativ i trafikut ajror, shërbimi i kontrollit të trafikut ajror (i kontrollit të ajrit, kontrollit të afrimit apo të kontrollit të aerodromit)
Shërbimi i Kontrollit të Trafikut Ajror (KTA)	Një shërbim i siguar për qëllimin e: a) parandalimit të përplasjeve : 1) midis avionave dhe 2) midis avionit dhe objekteve penguese mbi zonën e manovrimit dhe b) lehtësimit, mbarëvajtjes së saktë dhe menaxhimit të fluksit të trafikut ajror
Kërkesat e Përbashkëta	Kërkesa të Rregullores së (KE) që duhet të përmbushë një Ofrues SHNA që të certifikohet në ofrimin e shërbimit.
Qiell i Vetëm Evropian	Nje European (QVE) Qiell i Vetëm një koncept dhe paketë rregulloresh mbështetëse për operim të zbutur në sistemet e trafikut ajror ndërlidhur me pajtueshmërinë, nivelin e lartë të sigurisë në shërbimet navigacionale ajrore për mundësimin e përdorimit optimal të hapësirës ajrore Evropiane dhe pajtueshmërinë, nivelin e lartë të sigurisë në udhëtimet ajrore ,duke ju përmbajtur interesave të përgjithshme të shërbimeve navigacionale ajrore, përfshirjen e detyrimeve për shërbimin publik. Ofrimi i shërbimit duhet të zbatohet me standartet më të larta të përgjegjesisë dhe kompetencës.
Realizimi i sigurisë	Rezultati i procesit dhe/ose metodat e aplikuar për të arritur siguri të pranueshme ose të tolerueshme.
Objektivi i sigurisë	Një objektivi i sigurie është një synim i planifikuar i sigurisë. Realizimi i një objektivi mund të jetë demonstruar nga mjetet përkatëse të përcaktuara në përputhje me rregulloren e sigurisë.
Kërkesa mbi sigurinë	Një mjet i zbutjes së rrezikut, i përcaktuar prej strategjisë së zbutjes së rrezikut që arrin një Objektiv Sigurie të caktuar. Kërkesat e sigurisë mund të marrin forma të ndryshme, duke përfshirë kërkesa organizative, operacionale, procedurale, funksionale, ekzekutimi dhe ndërvepruese apo karakteristika mjedisore.

ESARR	EUROCONTROL Safety Regulatory Requirement (Kërkesat Rregullatore të Sigurisë të Eurokontrollit).
Rregullore	Përvetësimi, dekretimi dhe vënia në zbatim i rregullave për arritjen e objektivave të shpallura nga ata tek të cilët aplikohet procesi rregullator.
Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë (SMS)	Një trajtim sistematik dhe i hollësishëm që përcakton aktivitetet me anë të të cilave menaxhimi i sigurisë është ndërmarrë nga një autoritet i emëruar në mënyrë që të arrihet siguria e pranueshme dhe e tolerueshme.
Mbikqyrja e Sigurisë	Funksioni i ndërmarrë nga autoriteti i emëruar AKM për të verifikuar që objektivat e rregullores së sigurisë janë arritur dhe kërkesat e saj janë përmbushur me efikasitet
Kreu i AKM	Kreu i Mbikqyrjes së SHNA ose përfaqësuesi i përcaktuar i tij për një procedurë të posaçme.
Kërkesë-Rregullorja e Sigurisë	Kushti zyrtar i caktuar nga rregullatori i sigurisë i lidhur me specifikimin, i cili nëse pajtohesh me të, do të të çojë drejt njohjes dhe respektimit të kompetencës së sigurisë.
Çertifikata e Kompetencës Kompetenca	Një shprehje e përdorur në ESARR 5 me të njëjtin kuptim si “çertifikata e kompetencës dhe liçencës”, “liçencë ose çertifikatë” dhe “liçencë” e përdorur në ICAO Annex 1 dhe Konventën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.
Trafik i Përgjithshëm Ajror	(GAT) Përfshin të gjithë fluturimet që kryhen në përputhje me rregullat dhe procedurat e ICAO. GAT mund të përfshijë edhe avionat ushtarak qe zbatojne rregullat e ICAO.
Trafik Ajror Operacional	(OAT) Përmbledh të gjithë fluturimet që nuk përputhen me rregullat e vendosura për GAT dhe për të cilat autoriteti ka vendosur rregulla e procedura speciale.OAT mund të përmbledhë edhe fluturime civile të tilla si fluturime prove te cilat kërkojnë disa devijime nga rregullat e kërkesat e ICAO.

2. SHKURTIME

Shkurtime e perdorura ne kete udhezim kane kuptimet si meposhte:

- | | |
|---------------|--|
| 1. AKM | - Autoriteti Rregullator Kombëtar |
| 2. SHNA | - Shërbimi i Navigimit Ajror |
| 3. OSHNA | - Ofruesit e Shërbimit të Navigimit Ajror |
| 4. SHTA | - Shërbimi i Trafikut Ajror |
| 5. SHKTA | - Shërbimi i Kontrollit të Trafikut Ajror |
| 6. KTA | - Kontrolli i Trafikut Ajror |
| 7. KE | - Komisioni Evropian |
| 8. DPAC | - Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil |
| 9. ANTA sh.a. | - Agjensia Nacionale e Trafikut Ajror |
| 10. MTA | - Menaxhimi i Trafikut Ajror |
| 11. ECAC | - European Civil Aviation Conference |
| 12. VPSS | - (PSSA) Vlerësimi Paraprak i Sistemeve të Sigurisë. |
| 13. KNS | - Komunikim, Navigim dhe Survejim |
| 14. VSS | - (SSA) Vlerësimi i Sigurisë së Sistemeve |
| 15. VFR | - (FHA) Vlerësimi Funkcional i Rrezikut |
| 16. SITA | - (AFIS) Sistemi i Informimit të Transportit Ajror |
| 17. ZPEA | - Zona e Përbashkët Evropiane e Aviacionit |
| 18. SMS | - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë |
| 19. QVE | - (SES) Qiell i Vetëm Evropian |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Ministri

MIRATOHET

MINISTRI I
PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

SOKOL OLLDAS



UDHËZIM

Nr...18...datë ..16.10.2008

Për Çertifikimin e një Ofruesi Shërbimesh të Navigimit Ajror

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, në përputhje me Ligjin 9658, datë 18.12.2006, për ratifikimin e "Marrëveshjes Shumëpalëshe midis Komunitetit Evropian dhe Shteteve të tij Anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjes dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Mbi Krijimin e një Zone të Përbashkët Evropiane të Aviacionit",

UDHËZOJ :

KAPITULLI 1

Të përgjithshme

1. Qëllimi

1.1 Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i objektivave për të garantuar implementimin dhe vënien në zbatim të KRRSE1/ESARR1 dhe kryerjen e procesit të Çertifikimit të Ofruesve të Shërbimeve të Navigimit Ajror.

2. Organet zbatuese

2.1 Ngarkohet DPAC, si organi i ngarkuar edhe me funksionet e Autoritetit Kombëtar Mbikqyres (AKM), të garantojë zbatimin e këtij Udhëzimi.

2.2 DPAC do të mbikqyre dhe do të garantojë zbatimin me përpikmeri të rregullave të vendosura në këtë Udhëzim, nga Ofruesit e Shërbimeve të Navigimit Ajror.

2.3 Kërkesat e përgjithshme të këtij Udhëzimi do të zbatohen nga departamentet e përcaktuara të Aviacionit Civil, ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror dhe nga i gjithë personeli i shërbimit të menaxhimit të trafikut ajror (MTA), përgjegjës për detyrat, të cilat brenda janë përcaktuar si të lidhura ngushtë me sigurinë.

2.4 Kërkesat do të zbatohen tek:
departamentet e përcaktuara të Aviacionit Civil, organizmat operative dhe individët e personelit, të cilët nepermjet pajisjeve të MTA të aprovuara për përdorim operacional, garantojnë shërbime.

3. Kërkesat e Sigurisë

3.1 Kërkesa të Përgjithshme

Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil duhet të garantojë, përmes aplikimit të auditimeve dhe proceseve rregullatore përkatëse, që organizmat dhe personeli përgjegjës për detyrat në lidhje me shërbimin e trafikut ajror apo që mbulon fushën e shërbimeve të trafikut ajror, të cilat janë konsideruar të lidhura me sigurinë e trafikut ajror, ka zbatuar detyrat sic janë të përcaktuara në këtë udhëzim.

3.2.1 Kërkesa të zbatuara nga DPAC

DPAC, është përgjegjëse që:

- a) të garantojë mbikqyrjen e përshtatshme dhe të mjaftueshme të rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim.
- b) të kryejë, pas hulumtimit përkatës mbi një terren të pranueshëm, veprimin rregullues përkatës në përputhje me specifikimet e këtij udhëzimi dhe me dispozitat e OSHNA.

3.2.2 Kërkesa të zbatueshme nga OSHNA.

Një OSHNA do të:

- a) garantojë implementimin e detyrave që i lindin asaj në bazë të përcaktimeve të këtij udhëzimi;
- b) garantojë që, në lidhje me procedurat e përcaktuara nga ky udhëzim, të dhënat që ekzistojnë, janë dokumentuar nga OSHNA, dhe vihen në dispozicion, me kërkesë të D.P.A.C.-së;
- c) garantojë që, nga një pikëpamje sigurie, metodat përkatëse të zgjedhura janë ato që duhen, për të garantuar plotësimin e dispozitave të zbatueshme të këtij Udhëzimi;

4. PËRJASHTIME

Në rastin e ekzistencës së rrethanave që bëjnë të pamundur zbatimin e kërkesave të (KRRSE/ESARR) 1, DPAC do të bëjë vlerësimin e tyre dhe me pas do të publikojë zyrtarisht, një dokument përjashtimi, i cili do të garantojë një nivel ekuivalent sigurie.

5. Termat e përdorur

5.1 Termat dhe shkurtime të përdorura në këtë Udhëzim sqarohen në shtojcën A, bashkëlidhur këtij Udhëzimi dhe përbejnë pjesë integrale të tij.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KAPITULLI 2

Çertifikimi i një Ofruesi Shërbimesh të Navigimit Ajror

1. Një OSHNA do të ofrojë shërbime të navigimit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë vetëm nëse mban një çertifikatë të vlefshme për të ofruar shërbime të tilla.
2. DPAC ne ushtrim të funksioneve të AKM do të certifikojë OSHNA-të/Njësitet që do të ofrojnë shërbim në Republikën e Shqipërisë.
3. Çertifikimi nga ana e DPAC-së për të ofruar shërbime do të kryhet vetëm nëse OSHNA-te/Njësitet operojnë në përputhje me Kërkesat e Përbashkëta për ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror të parashtuara në aktet normative që lindin si detyrim i "Marrëveshjes Shumepalëshe për Krijimin e një ZPEA".
4. Para se të japë çertifikatën për të ofruar shërbime DPAC-ja, do të kryejë mbikqyrjen e atij Ofruesi dhe/ose Njësie në përputhje me Kërkesat e Përbashkëta dhe ESARR 1. Mbikqyrja do të kryhet duke audituar OSHNA-të/Njësitet dhe duke verifikuar përputhshmërinë me këto kërkesa.
5. Një Çertifikatë për të ofruar SHNA do të jetë e kufizuar në kohë dhe mund të përmbajë kushte të vecanta të përcaktuara nga DPAC-ja.
6. Çdo Shërbim Navigimi Ajror i ofruar do të kryhet në përputhje me kushtet e çertifikimit. Pas çertifikimit DPAC mbikqyr në mënyrë të vazhdueshme kryerjen e aktivitetit të OSHNA-ve/Njësive në përputhje me Kërkesat e Përbashkëta dhe me kushtet e përcaktuara në çertifikatë. Në rastet kur konstatohen mospërputhje me kërkesat dhe kushtet e mësipërme, DPAC do të marrë vendim brenda një afati kohor prej jo më shumë se 30 ditësh, me anë të të cilit do të kërkohet OSHNA-së/Njësiesë kryerja e veprimeve korrektuese.
7. Një OSHNA/Njësi që kërkon të marrë një çertifikatë nga DPAC për të ofruar Shërbime Navigimi Ajror do të aplikojë tek DPAC duke përdorur "Formularin 1" bashkelidhur me këtë Udhezimi. Aplikimi do të kryhet minimalisht 120 ditë për OSHNA dhe 60 ditë për Njësine përpara datës së planifikuar për marrjen e çertifikatës.

8. Një OSHNA/Njësi që nuk do të ofrojë shërbime ndërkufitare do të aplikojë tek DPAC për një Certifikatë të Kufizuar duke përdorur "Formularin 1".
Certifikata e Kufizuar është e vlefshme vetëm brenda hapësirës ajrore nën përgjegjësinë e REPUBLIKES SË SHQIPËRISË.

Për të bërë një aplikim për një Certifikatë të Kufizuar, një ofruer i shërbimeve të trafikut ajror duhet të ofrojë shërbime ose të planifikojë për t'i ofruar ato, vetëm për kategoritë e mëposhtme:

- a) aviacionin e përgjithshëm;
- b) punët ajrore;
- c) transportin ajror komercial të kufizuar për avionat me masë maksimale të ngritjes me më pak se 10 ton ose më pak se 20 vënde pasagjerësh;
- d) transportin ajror komercial me më pak se 10,000 lëvizje në vit, pavarësisht nga masa maksimale e ngritjes dhe numri i vëndeve të pasagjerëve, 'lëvizjet' të llogaritura si shuma e uljeve dhe ngritjeve dhe e llogarituar si një mesatare mbi tre vitet pararendëse.

Për të bërë një aplikim për një Certifikatë të Kufizuar, një OSHNA i ndryshem nga ofruerit e Shërbimit të trafikut ajror, duhet të ketë një sasi të ardhurash bruto prej 1 000 000 EURO ose më pak nga shërbimet që ai ofron ose planifikon të ofrojë.

Për të bërë një aplikim për një Certifikatë të Kufizuar, një aplikant që ofron shërbime të Informacionit të fluturimit në aerodrome duhet të operojë rregullisht jo më shumë se një pozicion pune në çdo aerodrom.

9. Pavarësisht nga paragrafi 3 i këtij kapitulli, Certifikata e Kufizuar do të përfshijë disa devijime të veçanta në përputhje me aktet normative që lindin si detyrim i "Marrëveshjes Shumepalëshe për Krijimin e një ZPEA" mbi Kërkesat e Përbashkëta.

10. OSHNA-të/Njësitë që aplikojnë për çertifikim, gjatë aplikimit do të paraqesin dokumentacionin e specifikuar në Paragrafin 11 të këtij kapitulli dhe çdo kërkesë tjetër të kërkuar nga DPAC-ja dhe do të ndihmojnë e bashkëpunojnë siç kërkohet me auditimet dhe inspektimet.

11. Një OSHNA do t'i paraqesë DPAC-së një prezantim organizativ që do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Një deklaratë të firmosur nga Shefi Ekzekutiv i Organizatës ose ekuivalenti i tij që konfirmon se dokumentacioni i organizatës dhe çdo dokumentacion referues bashkëngjitur përshkruan përputhshmërinë aktuale dhe atë në vazhdim të organizatës me të gjitha Kërkesat e Përbashkëta dhe që pranon t'i japë DPAC-së çdo informacion për vlerësimin e përmbajtjes së prezantimit;

- Politikën e sigurisë (të organizatës në përputhje të Kërkesave të Përbashkëta në zbatim të marrëveshjes të ZPEA.
- Pozicionet e punës dhe emrat e drejtuesve kryesore të organizatës;
- Përgjegjësitë dhe përgjegjshmëritë e drejtuesve kryesore në lidhje me vënien në zbatim të Kërkesave të Përbashkëta në zbatim të marrëveshjes të ZPEA duke përfshirë:
 - i. Një përshkrim të plotë të funksioneve të menaxhimit të sigurisë të përcaktuara në organizatë me përgjegjësi për përpunimin dhe menaxhimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë;
 - ii. Përgjegjshmëritë dhe përgjegjësitë si edhe masat përkatëse për të garantuar që drejtuesi kryesor dhe organizata janë aktivisht të përfshirë në menaxhimin e sigurisë;
- Një skemë organizative që tregon qartë përgjegjësitë e menaxhimit në fushat që mbulohen nga Kërkesat e Përbashkëta;
- Një përshkrim të përgjithshëm të burimeve të fuqisë punëtore;
- Një përshkrim të përgjithshëm të pajisjeve të organizatës;
- Fushën e shërbimeve të ofruara nën këtë certifikatë;
- Procedurën për mirmbajtjen e prezantimit tek DPAC-ja si dhe për njoftimin e çdo ndryshimi;
- Një përshkrim të plotë se si organizata përmbush dhe do të vazhdojë të përmbushi Kërkesat e Përbashkëta të cilat mund të përfshijnë referenca specifike ose dispozita të disa, ose të të gjitha dokumentave të mëposhtme:
 - a) Manuali i Menaxhimit të Sigurisë
 - a) Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë (SMS) (duke përfshirë procedurat specifike për çdo njësi);
 - b) Studimi i Situatës së Sigurisë për çdo njësi (nëse është e mundur);
 - c) Manualet e Operimeve të Shërbimit të Trafikut Ajror për çdo njësi;
 - d) Proçeset e trainimit dhe mbrojtjes së kompetencës për kontrollorët e trafikut ajror të kërkuara nga DPAC-ja, ;
 - e) Procedurat inxhinierike për çdo njësi;
 - f) Proçeset për trainimin, kualifikimin dhe mbrojtjen e kompetencës për personelin inxhiniero-teknik të këkuara nga DPAC-ja Për Licencimin e personelit inxhiniero-teknik të OSHNA/Njesisë;
 - g) Dokumentacioni garantues i sigurisë që përfshin:
 - i. Informacione për ndryshimet që ndikojnë sigurinë tek çdo njësi;
 - ii. dokumentacionin lidhur me ndryshimet e procedurave të Shërbimit të Trafikut Ajror (instruksionet suplementare ose të përkohëshme, etj.);
 - iii. Vlerësimet e Sigurisë dhe Analizat e Rrezikshmërisë që shoqërohen me ndryshime në operim;

- iv. raportet e investigimit të brendshëm të sigurisë që shoqërohen me raportimet e ngjarjeve, ose të kryera si rezultat i ngjarjeve të lidhura me sigurinë të raportuara nëpërmjet një procesi të brendshëm raportimi;
 - v. protokollet dhe/ose proces-verbalet e takimeve të Komitetit të Sigurisë
 - vi. raportet ose shqyrtimet e inspektimeve të brendshme të sigurisë së bashku me protokollet e evidencës të veprimeve të ndërmarra për të zbatuar rekomandimet përkatëse;
 - vii. raportet e auditimeve të brendshme të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë për përputhshmëri dhe efikasitet.
- h) Sistemi i Garantimit të Cilësisë;
 - j) Manuali i menaxhimit të mbrojtjes fizike
 - k) Plan Biznesi Pesëvjeçar dhe Plani Vjetor;
 - l) Raporti Vjetor.

Lista e mësipërme nuk është përfundimtare dhe e fundme. OSHNA-të/Njësitë do të paraqesin dokumentat e mësipërme në përputhje me llojin e aplikimit për çertifikim.